


## Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vizitë zyrtare në Mal të Zi

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), gjatë vizitës së saj zyrtare në Mal të Zi, zhvilloi një takim me Ministrin e Administratës Publike, z. Marash Dukaj.



Në takimin e mbajtur në Podgoricë, u diskutua mbi reformat në administratën publike, forcimin e profesionalizmit në shërbimin civil, proceset e digjitalizimit dhe modernizimit të institucioneve publike, si dhe sfidat dhe prioritetet në kuadër të integrimit evropian.



Komisionerja prezantoi rolin dhe veprimtarinë e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Shqipëri, duke vënë theksin te mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil.



Në bisedë u evidentuan mundësitë për shkëmbim të eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e reformës së administratës publike, qeverisjes digjitale, sigurisë së informacionit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Komisionerja vlerësoi progresin e Malit të Zi në procesin e reformimit të administratës publike, si dhe rolin e tij aktiv në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe procesin e integritimit evropian, duke veçuar faktin se këtë vit Podgorica zyrtare kryeson edhe Procesin e Berlinit.



Palët shprehën gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin institucional përmes ndarjes së praktikave më të mira, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në iniciativa rajonale të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë.